



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

-----Organi Shqyrtues
i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 647/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Znj. Kimete Gashi-Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "Albkos Safety" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje zjarrfikëse", me nr. të prokurimit: 2022/642-22-5108-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Mitrovicës, me datën 22.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Albkos Safety" SH.P.K, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.11.2022 me numër të protokollit 647/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje zjarrfikëse", me nr. të prokurimit: 2022/642-22-5108-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Mitrovicës

II. ANULOHET Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 25.10.2022, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Mitrovicës, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje zjarrfikëse”, me nr. të prokurimit: 2022/642-22-5108-1-2-1.

Me 30.10.2022 OE “Albkos Safety” SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me vendim të datës 30.10.2022.

Me 11.11.2022 OE “Albkos Safety” SH.P.K”, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokoli: 647/22), kundër njoftimit për dhënie të kontratës të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 25.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;

Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Lidhur me pretendimin e OE ankues se vendimi i Autoritetit kontraktues me të cilin është rekomanduar për kontratë OE “ Tekniku” Sh.P.K është në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 pasi që OE në fjalë nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar specifikimet teknike minimale të detyrueshme të paktën tek 7 produkte.

Eksperti shqyrtues konstaton se duke u bazuar në katalogjet/broshurat që ka ofruar në ofertën e tij OE i rekomanduar për kontratë, qëndron pretendimi i OE ankues, pasi që OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat minimale të specifikimeve teknike të detyrueshme për produktet e caktuara.

Eksperti shqyrtues sqaron se specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet ti përmbushin në mënyrë që të konsiderohen të përgjegjshëm.

Duke pasur parasysh faktet dhe dispozitat ligjore, eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 7, 28, 56 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankes e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesuese e Panelit Shqyrtues

Kimete GASHI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Mitrovicës;

1x1 OE- “Albkos Safety” SH.P.K”;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.